

DITËLINDJA

Ministria e Kulturës, Certifikatë Mirënjohjeje për poetin Xhevahir Spahiu

Ministria e Kulturës nderon me një Certifikatë Mirënjohjeje, poetin Xhevahir Spahiu në 75-vjetorin e lindjes. Në ambientet e Akademisë së Shkencave u zhvillua ditën e hënë veprimtaria shkencore jubilarë, "Shenja e një breznie", organizuar nga Komisioni i Artit dhe Trashëgimisë, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe Qendrën Kombëtare të Leximit. Mori pjesë në këtë takim edhe zv.ministërja e Kulturës, Meri Kumbi, e cila, duke i shprehur mirënjohjen për kontributin që ai ka dhënë në letrat shqipe, i dorëzoi poetit edhe një pllakë simbolike, ku gdhendej një nga poezitë e tij. Në certifikatë lexohej: "Poet i që u shndërrua në shenjë që bashkoi një brezni krijuesish prej viteve 1970 e në vijim; që synoi të sjellë ndryshime në poetikë dhe në konceptet estetike krahasuar me të mëparshmit; që pasuroi vjershërinë shqipe me motivet metafizike; që shqiptoi me liri të druajtur pyetje ekzistenciale si në letërsinë e mëdha dhe jetoi si qytetar i denjë me sprova sfide epokën".

STUDENTËT

Pakti për Universitetin, Qendra e Kinematografisë lidh marrëveshje me studentët e Arteve

Ministria e Kulturës, Qendra Kombëtare e Kinematografisë dhe Universiteti i Arteve nënshkruan në datën 3 mars një marrëveshje bashkëpunimi. Marrëveshja u firmos prej titullarëve të institucioneve: Ministria e Kulturës, Elva Margariti, kryetari i QKK, Eduart Makri dhe Rektori i UA, Kastriot Çausi. Në kuadrin e Paktit për Universitetin, janë nënshkruar 10 marrëveshje mes UA dhe institucioneve nën varësinë e Ministrisë së Kulturës. Sipas Ministres Elva Margariti, detyra që i del Ministrisë së Kulturës është të monitorojë zbatimin e këtyre marrëveshjeve, që studentët, realisht, të bëhen pjesë e proceseve krijuese, të marrin pjesë në mënyrë aktive në realizimin e projekteve artistike, shfaqje, ekspozita, prodhime kinematografike etj. Sipas marrëveshjes së nënshkruar, Qendra Kombëtare e Kinematografisë ka për detyrë: Të mundësojë financimin e shtëpisë kinematografike të rekomanduar nga UA për të prodhuar filmat (punë diplome) të studentëve të vitit të 3-të, në studimet Bachelor, dega "Regji filmi & Televizioni", për vitin akademik 2019-2020; t'i bëjë studentët pjesë të aktiviteteve, ërkshop-eve, leksioneve të hapura, trajnimeve nga ekspertë vendas e të huaj; të mundësojë bursa për studentët, që pranohen në shkollat më të njohura të filmit në Europë; t'i bëjë pjesë të sheshshirimeve etj.

NDIHMA

SHBA, 800 mijë dollar për monumentet e kulturës, Ambasadorja Yuri Kim takon ministren Margariti

Në emër të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ambasadorja e SHBA në Tiranë, Yuri Kim shprehu gjithë mbështetjen e saj për të ndihmuar në rikuperimin e dëmeve të tërmetit të 26 nëntorit 2019, në monumentet e kulturës. Znj. Kim zhvilloi një vizitë në ambientet e Ministrisë së Kulturës. E shoqëruar nga Ministria e Kulturës, Elva Margariti ajo u njoh me godinën historike, ku është vendosur MK dhe të gjitha përpjekjet për ta kthyer atë në një pol kulturor për kryeqytetin dhe një hapësirë arti për të artistët e rinj. Ministria Margariti e njohu me nevojat emergjente, që paraqiten përpara institucionit që ajo drejton, jo vetëm në lidhje me restaurimin e monumenteve të kulturës, por edhe në ngritjen e një Biblioteke të re Kombëtare, rikonstruksionin e Bibliotekës së vjetër, digjitalizimin e trashëgimisë kulturore jomateriale, aftësimin e specialistëve të rinj në këtë fushë etj. Znj. Ambasadore shprehu kënaqësinë për të vizituar sitet e trashëgimisë kulturore, si Kruja apo godinën e vjetër të Bibliotekës Kombëtare. Pas largimit nga Ministria e Kulturës, bashkë me falënderimet për mikpritjen ajo u shpreh në rrjetet sociale se "SHBA do të shpenzojë 800 mijë dollarë për të riparuar dëmtimet e tërmetit në kalanë e Krujës, si dhe në sitet historike në Durrës dhe në Prezë".

VIZITA

Ministria kosovare, Vlera Dumoshi takon Ministren Margariti, së shpejti kalendar i përbashkët kulturor

Ministria e Kulturës, Elva Margariti priti ditën e premte, në ambientet e Ministrisë së Kulturës, ministren e re të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës, Vlera Dumoshi. Nënshkrimi i një marrëveshjeje të re, çuarja përpara e Kalendarit të përbashkët Kulturor Shqipëri-Kosovë, ishin dy nga çështjet kryesore të diskutimit, duke u ndalur në veçanti në bashkëpunimin në fushën e kinematografisë, ku Kosova ka shënuar hapa të rëndësishëm, por edhe rishikimi i legjislacionit për lehtësimin e qarkullimit të librit në të dyja anët e kufirit. Po ashtu nga të dyja palët u shpreh dëshira për sa më shumë bashkëpunime në fushën e artit, por edhe zhvillimin e aktiviteteve që kanë në qendër të tyre fëmijët, të cilët do të artistët dhe publiku i së ardhmes. Më pas, delegacioni nga Kosova u shoqërua në një vizitë në Galerinë Kombëtare të Arteve, ku drejtori Erzen Shkololli i udhëhoqi në pavijonet e hapura, si dhe e njohu me projektet e reja të institucionit. Ministria Dumoshi e ftoi Ministren Margariti, për një vizitë në Prishtinë, për të hedhur të tjera hapa mbi çështjet e diskutuara në Tiranë.

RINDËRTIMI

Thumana e Shijaku ngrihen nga e para, prezantohen projektet për banorët

Bashkë me modelet e shtëpive të reja, banorët e Thumanës morën lajmin e mirë se të gjithë ata që humbën banesa individuale, në tërmetin e 26 nëntorit 2019, do ta festojnë Vitin e Ri 2021 në shtëpitë e tyre. Në datën 3 mars, me Thumanën nisi turi i prezantimeve të projekteve të rindërtimit. Bashkë me kryeministrin Edi Rama, Ministrin e Shtetit, Arben Ahmetaj, deputetë të zonës e përfaqësues të pushtetit vendor, u prezantuan modelet e shtëpive, qendra komunitare, ku do të vendosen të gjitha shërbimet shëndetësore, posta etj., parqet çlodhëse e këndet e fëmijëve. Në Thumanë do të ndërtohen 168 banesa individuale. Në datën 7 mars, turi i prezantimeve ndaloi në Shijak, ku tipologjia e ndërtimeve është ndryshe nga ajo e Thumanës. Në Shijak janë identifikuar 10 zona për zhvillim. Përveç 598 apartamenteve të reja, parashikohet një infrastrukturë e re, shkollë, qendra shëndetësore, hapësira të gjelbërta... NUK bëhet fjalë për ndërtime të veçuara, por një projekt që do ta shndërron Shijakun në një qytet të ri.